



**BULETINI MUJOR I
SEMUNDSHMERISE
INFEKTIVE**

(Pasqyra 14 Sh)

**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

SHKURT, 2019

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Të dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin Shkurt janë të dhënat e raportuara nga të 36 rrethet e vendit.

1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit shkurt 2019 zënë 17.8 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 170.13/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohe që në nivel kombëtar toksikoinfeksionet alimentare paraqesin një incidencë 3.71/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë dhe Kavajë mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare. Duhet theksuar që numri i lartë i rasteve të raportuara me toksikoinfeksione alimentare dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e këtyre rrethëve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin shkurt me 17 raste (1.02/10.000 banorë) të konfirmuara dhe dy raste të konfirmuara janë raportuar nga rrethi i Beratit. Janë raportuar 26 raste me Shigeloze përkatësisht 22 raste (1.32/10.000 banorë) nga rrethi i Shkodrës, tre raste të suspektuara nga rrethi Dibër dhe një rast i konfirmuar nga rrethi i Beratit, 65+vjeç.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin Shkurt, 2019

(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste, Shkurt 2019	Incidenca Shkurt 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmonelozë	19	0.68
Shigeloze (Disenteri bacilare)	26	0.93
Dizenteri amebike	0	0


Toksikoinfeksione alimentare	104	3.71
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	4615	164.81
Semundje diarreike ne total	4764	170.13

2. Sëmundjet e EPI

2.1. Fruthi

Ne muajin shkurt 2019 janë raportuar 120 raste te dyshuar me fruth nga te cilët 62 u konfirmuan nga ana laboratorike. Nga rastet e konfirmuara me laborator, 18 raste ose 29 % e tyre i përkasin grupmoshës nen 2 vjeç, ndjekur nga grupmosha 26-30 vjeç me 9 raste ose 14.5 %. Rastet e tjera janë te shpërndara ne grupmoshat e tjera.

67.7% (42 raste) e rasteve te konfirmuara i përkasin rrethit te Tiranes, ndjekur nga Lezha me 19.4% (12 raste), Durrësi me 6.5%(4 raste) dhe Shkodra 3.2 5(2 raste).




Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara me fruth për muajin Shkurt 2019

Ne muajin shkurt 2018 janë raportuar 355 raste te dyshuar me fruth nga te cilët 158 raste u konfirmuan nga ana laboratorike. Nga rastet e konfirmuara me laborator , 53 raste ose 33.5 % e tyre i përkasin grupmoshës nen 2 vjeç,

ndjekur nga grupmosha 16-20 vjeç me 20 raste ose 12.7 %. Rastet e tje ra janë te shpërndara ne grupmoshat e tjera.

62% (98 raste) e rasteve te konfirmuara i përkasin rrethit te Tiranes, ndjekur nga Lezha me 12% (19 raste). Rastet e tjera janë te shpërndara ne 15 rrethet e tjera te vendit. Vërehet një rënie e rasteve te dyshuara me fruth ne muajin shkurt te vitit 2019 ne krahasim me te njëjtin muaj një vit me pare. Një informacion me te zgjeruar ju mund ta gjeni ne “Buletinin Javor te Fruthit”, ne website e ISHP.



Grafiku 2. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara me fruth për muajin Shkurt 2018


2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit shkurt 2019 janë raportuar 18 raste te reja me TB. Incidenca e TB 0.62/100.000 banore. Rastet e konfirmuara rezultojn se 13 raste ose 72 % janë TB pulmonar dhe 5 raste ose 38 % janë te formës ekstrapulmonare. Rastet me TB pulmonar te konfirmuar bakteriologjikisht janë 8 raste me sputum pozitiv dhe 5 raste rezultojnë me sputum negativ. Rastet pulmonare sputum pozitiv janë ne rrethet: 3 raste sputum pozitiv ne Durrës, 1 rast ne Fier , 1 rast ne Puke, 1 rast ne Dibër, 1 rast ne Elbasan dhe 1 rast ne Kukës. Rastet e raportuara me tuberkuloz pulmonar negativ janë: 3 nga Tirana, 1 Shkodra dhe 1 nga Kruja .Rastet TB ekstrapulmonare janë 5 dhe përkatësisht nga 1 rast ne Lezhe, 1 rast ne Korçë, 1 rast ne Gjirokastër ,1 rast ne Tirane. Format ekstrapulmonare janë: 2 raste limfoadenit TB , 1 rast pleurit dhe 2 raste versament pleurale .

Rastet janë te grup-moshave te ndryshme nga 15- 65 + vjeç. Ajo qe vihet re është se mosha mesatare e rasteve me TB është 37.4 (min 20 vjeç – max 72) . Raste dominojnë te jene ne moshat e reja. Persa i përket gjinisë raporti M;

F 2:1. Rastet me TB 70 % janë konfirmuar ne Spitalin Universitar “Shelqet Ndroqi” dhe 30 % e rasteve ne dispanseri. Rastet me TB te shtruar ne këtë spital janë testuar dhe për sëmundjen e HIV. 11 raste TB ose (61%) janë nga zonat urbane dhe 7 raste me TB ose (39 %) janë nga zonat rurale


:



Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve me TB sipas rretheve ne mënyre grafike

2.3. Vaksinimi

Mbulesa vaksinore e raportuar për vitin 2018 paraqitet në nivele mbi 95% për shumicën e antigenëve vaksinalë sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit. Vihet re një mbulesë e ulët për vaksinimet ndaj Fruth-Rubeolë-Parotit për fëmijët e moshës 1 vjeçare në nivel deri 94.1% si edhe rivaksinimet ndaj Tetanozit për moshën 14 vjeçare në nivel deri 94.5% dhe për moshën 18 vjeçare në nivel 91.8%. Tek rivaksinimet ndikon ndjeshëm lëvizja e popullatës, ndërsa tek fruthi ndikon hezitimi i prindërve dhe tendenca apo rekomandimi i gabuar i disa mjekëve për ta shtyrë vaksinimin përtej moshës 1 vjeçare.



Grafiku 4. Mbulesa vaksinale Janar-Dhjetor 2018

3. Zoonozat

Gjatë muajit shkurt me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te kanë raportuar ne nivel vendi shtate raste me bruceloze dhe vetëm një rast është i konfirmuar. Rastet e dyshuara i përkasin rretheve Durrës Elbasan, Fier, Kolonje, Lushnjë dhe Peqin përkatësisht me nga 1 rast. Gjate muajit shkurt është raportuar një rast i konfirmuar nga Lushnja, 60-64 vjeç, me Leptospiroze dhe një rast i konfirmuar nga Tirana i grupmohës 1-4 vjeç me Leishmaniaze viscerale.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike ne Shkurt 2019 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Shkurt 2019	Incidenca Shkurt 2019 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	7	0.25
Leptospirozë	1	0.04
Leishmaniaza viscerale	1	0.04
Leishmaniaza kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te sëmundshmërisë infektive gjate muajit shkurt 2019 janë raportuar ne total 10 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.36/100.000 banore) nga te cilat 2 raste janë Hepatite virale të paspecifikuar, 1 rast Hepatit viral as A as B (30-34 vjeç) i konfirmuar nga Elbasani dhe 5 raste Hepatit virale B te konfirmuara.

Ne lidhje me HBV, 5 rastet e konfirmuara janë raportuar përkatësisht nga rrethi Lushnjë (2 raste), Dibër, Pogradec dhe Tirane përkatësisht nga një rast.

Rastet me Hepatit viral B i përkasin grupmoshës se rritur përkatësisht nga 2 raste grupmosha 40-44 vjeç dhe përkatësisht nga një rast 45-49 vjeç, 55-59 vjeç dhe 60-64 vjeç.

Duhet te theksojme qe labororet nuk raportojne ne lidhje me testimet per Hepatitin B

5. Meningoencefalite

Gjate muajit Shkurt 2019 janë raportuar ne total 5 raste meningite bakteriale jo meningokoksike ku ne vetëm tre prej tyre, ne liquorin cerebrospinal eshte evidentuar prezence e larte e numrit te qelizave po pa percaktuar shkaktarin patogen. Rastet kane patur nje shperndarje sipas grupmoshave >1 vjec 1 rast, 1-4 vjec 2 raste, 15-19 vjec 1 rast dhe 25-29 vjec 1 rast dhe ne raport 1:4 meshkujt ndaj femrave. Sipas shperndarjes gjeografike dhe incidences, rastet e raportuara janë nga Tirana (0.06/10.000 banore) dhe Fieri (0.06/10.000 banore). Gjate muajit Shkurt është raportuar një rast encefalit i paspecifikuar nga Fieri, mashkull, grup-moshës 45-49 vjeç.

6. HIV/AIDS

Gjatë muajit Shkurt 2019 janë realizuar 46 ekzaminime me testin ELISA HIV 1+2 Ag/Ab. Nga këto testime, 6 prej tyre kanë rezultuar HIV pozitive. Shpërndarja sipas gjinisë e rasteve pozitive është e njëjtë. Shpërndarja gjeografike e tyre tregon se 5 raste i përkasin vendbanimit Tiranë dhe një rast në Shkodër. Tre nga rastet pozitive kanë ardhur pas testimit të kryer në 3 laboratorë (1 nga Spitali Amerikan, një nga Spitali Hygeia dhe një rast nga një laborator privat tjetër), një rast pas keshillimit te partnerit si pasoje e diagnozës së partnerit HIV pozitiv, një rast ka ardhur nga VCT e rrethit Shkodër (testim me kite të shpejta) dhe një rast është rekomandim nga Spitali Infektiv. Shpërndarja sipas grupmoshave e femrave pozitive është 25-34vjeç (1rast), 35-44 vjeç (1 rast), dhe rasti tjetër 55-64 vjeç. Meshkujt i përkasin grupmoshave: 16-24 vjeç (1rast), 25-34 vjeç (1 rast) dhe rasti tjetër 55-64 vjeç.

7. Gripi

Nga të dhënat e raportimit sipas survejancës së infeksioneve akute respiratore të sipërme dhe të poshtme të sistemit ALERT, survejancës sentinel të sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe survejancës së infeksioneve respiratore akute të rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se ne muajin Shkurt 2019 aktiviteti i tyre paraqet prirje të qëndrueshme ndërsa aktivitetit i gripit ishte i përhapur dhe me intensitet mesatar, me mbizotërim të qarkullimit të virusit të tipit A, nëntipi A/H1 pdm09. Një informacion me te zgjeruar ju mund ta gjeni ne “Buletinin Javor te Gripit”, ne website e ISHP.

8. Ethe hemorragjike

Gjatë muajit Shkurt 2019, mbështetur në survejancën e bazuar në rast është raportuar 1 rast i dyshuar me ethe hemorragjike. Pas hetimit epidemiologjik të rastit dhe kartelizimit të tij në QSUT, Shërbimi i sëmundjeve infektive, rasti ishte nga Tirana, në pension, 77 vjeç. Pas marrjes së mostrave serike sipas protokollit të ndjekjes së rasteve të dyshuara me ethe hemorragjike, mostra u testua në laboratorin e virologjisë pranë ISHP, nga ku rasti rezultoi negativ për ethe hemorragjike.

INSTITUTI I
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI